



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2022:069504

Datë: 30.06.2024

Numri i dokumentit: 05876825

KPPP.nr.457/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Hasan Kryeziu, në çështjen përmbartimore të kreditorit NPT. “Frutti”, me seli në Reqan, në Prizren, me numër të biznesit: 70016723, kundër debitorit The North Unicorn L.L.C, me NUI: 810112186, me seli në rr. “Zona Industriale”, në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqësojnë Arianit Koci dhe Granit Vokshi, avokatë nga Prishtina, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.129/2022 të datës 10.03.2022, të Përmbartuesit Privat Rushit Hoxha me seli në Prizren, jashtë seancës, me datë 28.06.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit The North Unicorn L.L.C., i paraqitur kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.129/2022 të datës 10.03.2022, të Përmbartuesit Privat Rushit Hoxha.
- II. MBETET në fuqi Urdhri Përmbartimor P.nr.129/2022 i datës 10.03.2022 i lejuar nga Përmbartuesi Privat Rushit Hoxha.
- III. URDHËROHET debitori “The North Unicorn L.L.C., që në rast të parashtrimit ankesës, të deponoj në llogari të veçantë të “Këshillit Gjyqësor të Kosovës”, nëpërmjet arkës së Gjykatës Themelore në Prishtinë, garancionin në shumën prej 42,829.80 €, (katërdhjetë e dy mijë e tetëqind e njëzet e nëntë euro e tetëdhjetë cent), në afat prej 7 (shtatë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij aktvendimi.
- IV. Nëse debitori nuk e deponon garancionin brenda afatit të caktuar, ankesa e ushtruar kundër këtij aktvendimi, do të konsiderohet se nuk është dorëzuar fare nga pala ankuese.

## A r s y e t i m

Përmbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të autorizuarit të kreditorit NPT. “Frutti”, ka lëshuar urdhrin përmbarimor P.nr.129/2022 të datës 10.03.2022, me të cilin ka lejuar përmbarimin, në bazë të dokumentit të besueshëm: Faturës Nr. 21/0492 PR të datës 22.02.2021; Faturës Nr. 21/0736 PR të datës 11.03.2021; Faturës Nr. 21/0901 PR të datës 24.03.2021; Faturës Nr. 21/01070 PR të datës 06.04.2021; Faturës Nr. 21/01145 PR të datës 14.04.2021; Faturës Nr. 21/01559 PR të datës 19.05.2021; Faturës Nr. 21/01651 PR të datës 26.05.2021; Faturës Nr. 21/01870 PR të datës 14.06.2021; Faturës Nr. 21/01961 PR të datës 18.06.2021; Faturës Nr. 21/02260 PR të datës 12.07.2021; Faturës Nr. 21/02786 PR të datës 19.08.2021; Faturës Nr. 21/02883 PR të datës 27.08.2021; Faturës Nr. 21/02932 PR të datës 03.09.2021; Faturës Nr. 21/03645 PR të datës 03.11.2021; Faturës Nr. 21/03735 PR të datës 11.11.2021; Faturës Nr. 21/03856 PR të datës 22.11.2021; Faturës Nr. 21/03949 PR të datës 08.12.2021; Faturës Nr. 21/04173 PR të datës 22.12.2021; Faturës Nr. 2560 të datës 11.09.2020; Faturës Nr. 2543 të datës 10.09.2020; Faturës Nr. 1283 të datës 22.05.2020; Faturës Nr. 1284 të datës 22.05.2020 dhe Faturës Nr. 22/630 PR të datës 02.03.2022; me të cilën është obliguar debitori që në afat prej 7 ditëve nga pranimi i urdhrit të përmbush detyrimin në shumën e mbetur prej 42,829.80 €, me kamatë ligjore, si dhe të paguaj gjitha shpenzimet e procedurës përmbarimore, me realizimin e përmbarimit përmes llogarive bankare të debitorit dhe përmes sekuestrimit të sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit deri në shlyerjen e obligimeve që debitori ka ndaj kreditorit.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, përmes përfaqësuesve të autorizuar, ka kundërshtuar urdhrin përmbarimor, duke theksuar ndër të tjerash se me kreditorin kanë pasur marrëveshje furnizimi me materiale ushqimore, e për këtë me datë 01.01.2021 kishin lidhur kontratën e shitblerjes, megjithatë përkundër këtij bashkëpunimi urdhri për përmbarim nuk i përmban elementet esenciale të cilat kërkohen, ngase kërkohet që minimumi një faturë të jetë e nënshkruar nga ana e palës debitore. Më tutje ka shtuar se me datë 10.03.2022 ka bërë një pagesë në drejtim të kreditorit në vlerën prej 1,000.00 €, pastaj me datën 21.12.2021 ka realizuar pagesën në vlerën prej 5,000.00 €, ashtuqë në asnjë rrethanë nuk mund të jetë borxhi i kërkuar si në propozim. I ka propozuar gjykatës që të aprovohet në tërësi prapësimi i debitorit, të

shfuqizohet urdhri përmbartimor, si dhe të obligohet kreditori që t'i paguaj shpenzimet për përpilimin e prapësimit në vlerë prej 156.00 € sipas tarifës së odës së Avokatëve.

Kreditore në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, ka kundërshtuar në tërësi prapësimin e debitorit, duke deklaruar se faturat e bashkëngjitura në propozim i përmbajnë të gjitha elementet e duhura konform dispozitave ligjore, për faktin se këto fatura janë të nënshkruara nga palët, si dhe janë dorëzuar në origjinal. Në lidhje me pretendimet e debitorit rreth pagesave të faturave, ka theksuar se në lidhje me këto pagesa të realizuara me anë të së cilës është paguar një pjesë e borxhit, kreditore nuk ka kërkuar këtë pjesë të borxhit në propozim. Gjykatës i ka propozuar që ta refuzoj prapësimin e debitorit si të pa bazuar, si dhe të paguaj të gjitha shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjen në prapësim të kreditorit, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i pa bazuar, duke vendosur sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret faturat në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përmbartim, i plotësojnë kushtet për të qenë dokument i besueshëm dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara dhe janë të përshtatshme për përmbartim, bazuar në dispozitat e nenit 29 par.3 dhe 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditore dhe debitor, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar “*. Me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t'i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*, ndërsa sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm sipas të cilit mund të caktohet përmbartimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Gjykata vlerëson se urdhri i lejuar nga ana e përmbaruesit privat bazohet në dokumentin e besueshëm - Faturën Nr. 21/0492 PR të datës 22.02.2021; Faturën Nr. 21/0736 PR të datës 11.03.2021; Faturën Nr. 21/0901 PR të datës 24.03.2021; Faturën Nr. 21/01070 PR të datës 06.04.2021; Faturën Nr. 21/01145 PR të datës 14.04.2021; Faturën Nr. 21/01559 PR të datës 19.05.2021; Faturën Nr. 21/01651 PR të datës 26.05.2021; Faturën Nr. 21/01 870 PR të datës 14.06.2021; Faturën Nr. 21/01961 PR të datës 18.06.2021; Faturën Nr. 21/02260 PR të datës 12.07.2021; Faturën Nr. 21/02786 PR të datës 19.08.2021; Faturën Nr. 21/02883 PR të datës 27.08.2021; Faturën Nr. 21/02932 PR të datës 03.09.2021; Faturën Nr. 21/03645 PR të datës 03.11.2021; Faturën Nr. 21/03735 PR të datës 11.11.2021; Faturën Nr. 21/03856 PR të datës 22.11.2021; Faturën Nr. 21/03949 PR të datës 08.12.2021; Faturën Nr. 21/04173 PR të datës 22.12.2021; Faturën Nr. 2560 të datës 11.09.2020; Faturën Nr. 2543 të datës 10.09.2020; Faturën Nr. 1283 të datës 22.05.2020; Faturën Nr. 1284 të datës 22.05.2020 dhe Faturën Nr. 22/630 PR të datës 02.03.2022; i përmbajnë të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm sipas nenit 29 par. 3 të LPP-së, meqenëse në këto fatura janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara mallrat të cilat kanë qenë objekt i këtyre faturave është përcaktuar shuma e cila përben detyrim për përmbushje nga ana e debitorit, si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi.

Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se në rastin konkret faturat e lartcekura i plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 37 të LPP, për zbatimin e përmbarimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që të njëjtat janë dorëzuar në origjinal, mbajnë vulën dhe nënshkrimin e pranimit të debitorit, si dhe nuk janë kontestuar asnjëherë nga debitori.

Gjykata vlerësoi pretendimin e debitorit, se në rastin konkret ka paguar disa detyrime sipas faturave kontestuese, mirëpo gjeti se një pretendim i tillë është i pa bazuar, për faktin se debitori nuk ka dorëzuar asnjë dëshmi përmes së cilës do të mund të vërtetohej një fakt i tillë, meqenëse nga fletëpagesat e dorëzuara, nuk rezulton se borxhi i paguar ka të bëjë me faturat kontestuese për të cilat është iniciuar propozimi për përmbarim.

Gjykata i vlerësoi edhe pretendimet tjera të debitorit, mirëpo gjeti se të njëjtat nuk mund të jenë objekt shqyrtimi i procedurës përmbarimore prandaj dhe nuk mund të vlerësohen në këtë procedurë, ngase kjo procedurë i nënshtrohet parimit të formalitetit rigoroz, në bazë të cilit nuk lejohet vlerësimi i rrethanave tjera, përpos vlerësimit të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbarimi, si dhe përshtatshmërisë së vendimit si objekt përmbarimi.

Në pikën III të dispozitivit të këtij aktvendimi, gjykata ka urdhëruar debitorin që në rast të parashtrimit të ankesë kundër këtij aktvendimi, të deponoj garancinë në gjykatë, në shumën e përcaktuar si në këtë pikë të dispozitivit të këtij aktvendimi dhe gjykatës t'ia dorëzoj provën për pagesën e garancionit, konform dispozitës ligjore të nenit 78 par.2 dhe 4 të LPP-së.

Andaj bazuar në të lartcekurat, gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga arsyet e paraqitura më lart dhe duke u bazuar në nenin 73 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.457/23, datë 28.06.2024

Gjyqtari

Hasan Kryeziu

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.